



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

C.nr.576/2015

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, (e vendosur ne objektin e Degës së Kësaj Gjykate në Vushtrri), si kontestimore e përbërë nga gjyqtari individual Faton Ademi, në çështjen juridike të paditëses: nga Mitrovica kundër të paditurës:

Mitrovicë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit me shkrim , baza e kontestit: pagesa e pagave përcjellëse në pensin si dhe shpërblimit jubilar, në seancën e datës: 12.10.2016 konform nenit 148 të LPK-së bjen këtë:

A K T G J Y K I M
- në bazë të pohimit -

- 1. OBLIGOHET** e paditura Spitali Rajonal "Dr." në Mitrovicë që paditësen nga Mitrovica në emër të një page përcjellëse dhe dy pagave shpërblim jubilar t'ia paguajë shumën prej 1.087 50 euro brenda afatit 15 ditor nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.
- 2.** Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale

A r s y e t i m

Paditësi me datë: 13.10.2015 ka parashtruar në gjykatë padi kundër të paditurës për pagesën e pagave përcjellëse dhe pagave për shpërblim jubilar.

Gjykata me datë: 12.10.2016 ka mbajtur seancën kryesore në këtë çështje juridike, ku paditësja e ka precizuar kërkesëpadinë sepse pas pensionimit e ka marrë një pagë përcjellëse dhe tani kërkoj edhe një pagë tjetër përcjellëse si dhe dy paga në emër të shpërblimit jubilar ku shuma e përgjithshme të jetë 1.087.50 euro.

Përfaqësuesi i të paditurës deklaroi se nuk e konteston kërkesën e prezentuar nga paditësja sa i përket pagës së një page përcjellëse dhe dy pagave në emër të shpërblimit jubilar me rastin e pensionimit.

Meqenëse pala e paditur tani nuk e kundërshtoi kërkesëpadinë por e pohoi një gjë të tillë gjykata konform dispozitave ligjore mori aktgjykim në bazë të pohimit, pasi që nuk bëhej fjalë për kërkesë me të cilat palët nuk mund të disponojnë siq parashihet me nenin 3.3 të LPK-së.

Andaj duke u bazuar në nenin 148 të LPK-së gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICE,
C.nr. 576/2015 Me dt.12.10.2016.

GJYQTARI,
Faton Ademi



UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejt ankese në afat 15 ditor, Gjykatës së Apelit nëpërmjet kësaj gjykate.